

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KOMISIONIN NDËRKOMBËTAR PËR EKSPLOKORIMIN SHKENCOR NË DETIN MESDHE”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe, propozohet si rrjedhojë e faktit që Shqipëria është një nga shtetet që laget nga Deti Mesdhe, për të kryer hulumtime, studime dhe punë oqeanologjike në këtë det.

Projektligji ka si qëllim që të kontribuojë në zbulimin dhe mbrojtjen e Detit Mesdhe dhe deteve që kontribuojnë në këtë det.

Ky Komision, me seli në Monako, përbëhet nga 23 shtete anëtare. Këto shtete mbështesin një rrjet me disa mijëra studiues detarë, të cilët përdorin mjetet më të fundit shkencore për të kuptuar, monitoruar dhe mbrojtur më mirë Detin Mesdhe i cili po ndryshon shpejt dhe po sjell ndikime të mëdha.

I strukturuar me 6 komitete dhe task-forca të ndryshme, KNESHDM organizon takime me ekspertë, programe bashkëpunimi dhe kongrese në mënyrë periodike, duke ofruar orientime dhe këshilla të pavarura nga agjencitë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Komisioni integron një spektër të gjerë të disiplinave detare, duke përfshirë proceset gjeo-fizike, kimike dhe biologjike, së bashku me hartat me rezolucion të lartë të fundit të detit. Ndryshimet në Detin Mesdhe po ndodhin në mënyrë të shpejtë dhe të pashembullt. Është pikërisht Komisioni që gjurmon dhe analizon këto ndryshime, të cilat vijnë nga ndikimi i ngrohjes globale në nivelin e detit dhe masat ujore deri te ndryshimet në biodiversitetin detar.

KNESHDM-ja përfshin në aktivitetet e tij studiues nga të gjitha brigjet e Basenit. Duke qenë se Deti Mesdhe është një trashëgimi shekullore, shtetet kanë si objektiv të mundësojnë shkëmbimin e standardeve dhe ideve shkencore, por edhe të mbajnë një dialog konstruktiv, paqësor midis tyre pasi për një kohë të gjatë, ato kanë qenë të ndarë nga konfliktet historike.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektkteve për vitin 2019 të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Gjithashtu, ky projektligj është në përputhje me programin politik të qeverisë dhe programin e përgjithshëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për nismat ligjore dhe nënligjore, që duhen ndërmarrë për përmirësimin e kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator për mjedisin, që kanë si qëllim të promovojnë ndërmarrjen e veprimeve më të forta ndaj ndryshimeve klimatike, zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe mbrojtjes së mjedisit për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nevoja e hartimit të këtij projektligji vjen si rezultat:

Së pari, si rezultat i aderimit në këtë Komision, i cili është krijuar nga “Nisma për Zhvillimin e Qëndrueshëm Financiar të Zonave të Mbrojtura Detare të Mesdheut”, nën kujdesin e Princit Albert II i Monakos, Republika e Shqipërisë do të përfitojë ndihmë teknike dhe financiare, nëpërmjet projekteve të vogla dhe të mesme, për të mbrojtur dhe për të zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme zonën detare të rajonit tonë.

Së dyti, kjo nismë ka një rëndësi rajonale, pasi ndjek një politikë ambicioze për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura. Ajo gjithashtu do të investojë në forcimin e vlerave ekologjike sociale dhe ekonomike duke inkurajuar krijimin e zonave të mbrojtura detare të reja, si dhe mbledhjen e fondeve për plotësimin e sistemit aktual të financimit nëpërmjet mekanizmave inovativë.

Duke qenë se pjesë e këtij Komisioni janë 23 shtete, sugjerojmë që Shqipëria të jetë pjesë e këtij projekti rajonal.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në harmoni me Kushtetutën dhe me ligjin nr.43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Komisioni Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe (KNESHDM) është një organizatë ndërqeveritare e cila gëzon zotësi juridike. KNESHDM-ja përbëhet nga të deleguarit e shteteve nënshkruese që lagen nga Deti Mesdhe dhe nga detet që e përbëjnë këtë det si dhe nga të deleguarit e qeverive të shteteve nënshkruese, që nuk lagen nga ky det, por që kryejnë hulumtime, studime dhe punë oqeanologjike në këtë det. Miratimi i teknologjive të reja do t'u mundësojë vendeve palë të fitojnë avantazhe konkurruese në treg, pasi shumë prej teknologjive alternative të zhvilluara së fundi kanë si efekt direkt rritjen e efikasitetit të energjisë dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve.

Në kuadër të këtij objekti dhe qëllimi, KNESHDM-ja:

- favorizon punimet hulumtuese në bashkëpunim me institutet kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare që kanë qëllime të ngjashme;
- nxit programet multilaterale të mbikëqyrjes së mjedisit detar;
- lehtëson shkëmbimet e informacionit dhe botimet veçanërisht në fushën e oqeanografisë, biologjisë ujore, gjeologjisë ujore dhe të biogjeokimisë.

Shtetet nënshkruese, me anëtarësimin në KNESHDM angazhohen për një periudhë pesëvjeçare e cila, me mbarimin e saj, ripërtërihet në heshtje për një periudhë tjetër prej pesë vjetësh me përjashtim të rastit kur shteti, një vit përpara mbarimit të afatit, denoncon ripërtëritjen nëpërmjet një njoftimi që i dërgohet drejtorit të Përgjithshëm. Anëtarësia ripërtërihet me periudha pesëvjeçare.

Republika e Shqipërisë, pas miratimit të ligjit aderues, do të bëjë njoftimet përkatëse sipas parashikimeve të neneve 4 dhe 5, të statutit të KNESHDM-së.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e projektligjit janë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare për Zonat e Mbrojtura.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Angazhimi si anëtar i KNESHDM-së sjell si pasojë detyrimin për të derdhur një kontribut vjetor, të përcaktuar nga Byroja prej 25 000 eurosh.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është institucioni kompetent për derdhjen vjetore të kontributit.

KËSHILLI I MINISTRAVE